



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 82 Datë 28.05.2020

“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, udhëzimin nr. 23, datë 30.12.2008 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për përmbajtjen e bonusit të strehimit”, VKM nr. 1093 date 28.12.2015 “ Per miratimin e procedurave, kriterëve dhe perparësive per dhenien e bonusit te strehimit” i ndryshuar, referuar dokumentacionit te paraqitur se sektorin e administrimit te pronave dhe strehimit, ne kontraten e qerases vlere mujore e pageses eshte 15000 mij/lek. Me propozim te Kryetarit të Bashkisë ne mbledhjen e këshillit bashkiak te dates 28.05.2020

Keshilli Bashkiak, ne mbledhjen e tij, datë 28.05.2020 me 18 vota pro 1 vota kundër.

**VENDOSI :**

1. Të miratojë trajtimin me bonus strehimi ne vleren 50 % te vleres se qerases familjen e z. Xhevdet Hasan Kurti ne shumen 7500 (shtatemije e peseqind ) lekë në muaj,
2. Të miratojë trajtimin me bonus strehimi ne vleren 50 % te vleres se qerases familjen e zj. Alma Selman Derti ne shumen 7500 (shtatemije e peseqind ) lekë në muaj.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “I”, në shumën prej 7500 (shtatemije e peseqind) lekë në muaj, do të përballohen nga buxheti i shtetit.
4. Efektet financiare kanë një kohëzgjatje nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi deri ne zgjidhjen e problemit te strehimit.
5. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Administrimit te Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.